



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË  
KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA BALLI KOMBËTAR, PJESTARE E  
KOALICIONIT "SHPRESA PËR NDRYSHIM", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E  
QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për pranimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë, Korçë, Vlorë, të paraqitura nga Partia Balli Kombëtar, pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Balli Kombëtar, si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Partia Balli Kombëtar, me vendimin e KQZ-së nr. 226, datë 27.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e KQZ-së nr. 273, datë 10.05.2019, është regjistruar koalicioni "Shpresa për Ndryshim", pjesë e të cilit është dhe Partia Balli Kombëtar.

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë, Korçë, Vlorë.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkive: Lezhë, Tiranë, Korçë, Vlorë; pasi bashkitë Lezhë, Tiranë, Korçë, Vlorë administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Partia Balli Kombëtar, nuk ka plotësuar dokumentacionin e plotë për regjistrim e listave shumemërore të kandidatëve për Këshillin e Bashkisë Korçë, brenda afatit ligjor. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose



**Nr. 621 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Balli Kombëtar", pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

ushtrojnë funksione publike”, Partia Balli Kombëtar nuk ka depozituar në KQZ formularët e vetëdeklarimit për Këshillin e Bashkisë Korçë. Referuar nenit 5, pika 2, parashikohet se, “Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për mosregjistrimin e kandidatit në zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo për mosemërimin nga organi përgjegjës sipas ligjit. Modeli i formularit të vetëdeklarimit miratohet me vendim të Kuvendit”.

Në këto kushte KQZ referuar nenit 73, pika 2, duhet të refuzojë listat e kandidatëve për Këshillin Bashkisë Korçë të Partisë Balli Kombëtar.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive Lezhë, Tiranë, Vlorë;
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtar këshilli në Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë, Vlorë, të propozuar nga Partia Balli Kombëtar;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Vërtetimet e Kuvendit të Shqipërisë, për zotërimin e 6 mandateve të z. Koçi Tahiri, znj. Elda Hoti, znj. Majlinda Halilaj, z. Zef Shtjefni, z. Kostaq Papa, z. Adriatik Alimadhi, dorëzuar me shkresën përcjellëse me nr. 4031 prot., datë 20.05.2019 sipas të cilit vërtetohet se koalicioni zotëron 6 mandate në Kuvend sa numri i partive pjesëmarrëse.
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në mbledhjen e datës 22.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive Bashkive: Lezhë, Tiranë, Vlorë të Partisë Balli Kombëtar dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillin bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për të kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, nga ku rezulton se:

#### **Lista shumemërore e Bashkisë Lezhë:**

Kandidati me numër **rendor 01, z. Artan Mhill Ndreu**, në bazë të vendimit nr. 93 datë 17.07.2000 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e ka deklaruar fajtor për veprën penale “Organizim e pjesmarrje në grumbullime e manifestime të paligjshme në bashkëpunim”, e në bazë të nenit 262/1, 25 të Kodit Penal dhe nenit 406 Kodit Procedurës Penale e dënon me 1 (një) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) muaj burgim. Në bazë të nenit 69 Kodi Penal rehabilitohet.

Kandidati me numër **rendor 05, z. Agron Lek Prendaj**, në bazë të vendimit nr. 21 datë 23.01.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e ka deklaruar fajtor për veprën penale “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, e në bazë të nenit 291 të Kodit Penal e dënon me 3 (tre) muaj burgim. Në zbatim të nenit 406 Kodit Procedurës Penale dënohet përfundimisht me 2 (dy) muaj burgim. Në aplikim të nenit 63 Kodi Penal e urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me 40 (dyzetë) orë punë në interes publik.



### **Lista shumemërore e Bashkisë Tiranë:**

Kandidati me numër **rendor 17, z. Fitim Hasan Beka**, në bazë të vendimit nr. 549 datë 27.02.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt", parashikuar nga neni 291 K.P dhe neni 406 K.Pr.P e dënnon me 2 muaj burgim. Në aplikim të nenit 63 K.P urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me 80 orë punë në interes publik.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015.

KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 22.05.2015, verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive Lezhë, Tiranë, Vlorë dhe dokumentacionin bashkëngjitur, të depozituar nga "Partia Balli Kombëtar" dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72 të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1, pika 2 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin e Bashkive: Lezhë, Tiranë, Vlorë të Partisë Balli Kombëtar, pjesëtare të Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Refuzimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin e Bashkisë Korçë pjesëtare të Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
- 3.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 621 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Balli Kombëtar", pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019